

S. Felin. Gjykatësia e Komit.  
dt. 18.07.2022



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA E RRETHIT GJYQESOR  
KORÇE

BASHKIA M/

Zyra e Protokollit

Nr. 3780... Pr...

Date 18.07.2022

M. Boka

Korçë, me 13.07.2022

**SHPLLJE VENDIMI**

Drejtuar : Bashkise Maliq

Per: shtetasen : Almira Merolli (Hoxhaj), me adrese Maliq

Bashkalidhur po ju dergojme shpalljen per vendimin civil nr. 405, dt. 26.05.2022 per t'u afishuar nga ana Juaj njoftimi me shpallje me afat 20 ditor, pasi deftesa e komunikimit eshte kthyer me shenimin : " Larguar " dhe pas afishimit kjo shpallje te na kthehet e konfirmuar me vule e firme, ne gjykate.

KANCELARE  
Lubiana KINOLLI

U afishua sot ne date -----

Bashkia Maliq

Nenpunesi \_\_\_\_\_

(emer, mbiemer, firme)

Nr. 85 Prot  
dt. 18.07.2022



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR  
KORÇË

Nr.regj.them.21001-00754-41-2022 (995)  
Datë regjistrimi 12.05.2022

Nr.vendimi 41-2022-1590 (405)  
Datë vendimi 26.05.2022

VENDIM

"NË EMËR TË REPUBLIKËS"

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë, me trup gjykues të përbërë prej:

Gjyqtarit të vetëm **Seladin PYSQYLI**, asistuar nga sekretare Brilda Hoxhallari, në gjykatë, sot më datë 26.05.2022, përfundoi gjykimin e çështjes civile me palë dhe objekt:

**PADITËSE:** **Almira Merolli**, e bija e Vangjel dhe Burbuqe, e datëlindjes 13.04.1982, lindur në Maliq, banuese në Korçë, lagja 17, Rr. "Riza Mançe", nr.32 (pranë Hotel Konti), aktualisht me qëndrim në Maliq, në familjen e prindërve (babit Vangjel Hoxhaj).

**I PADITUR:** **Fatos Merolli**, i biri i Islam dhe Shaqe, i datëlindjes 12.06.1970, lindur e banues në Korçë, lagja 17, Rr. "Riza Mançe", nr.32 (pranë Hotel Konti).

**OBJEKTI:** Zgjidhjen e martesës ligjore të lidhur midis palëve më datë 25.09.2000 dhe të pasojave që vijnë nga zgjidhja e martesës.

**Baza ligjore:** Neni 132 e vijues i K.Familjes.

Në seancën e sotme për pajtim u paraqitën të dyja palët, ku paditësja deklaroi se heq dorë nga gjykimi i padisë dhe kërkoi pushimin e gjykimit të çështjes.

Gjykata, pasi dëgjoi paditësen dhe morri mendimin e të paditurit,

VËREN SE:

Me padinë drejtuar gjykatës paditësja ka kërkuar zgjidhjen e martesës ligjore të lidhur më datë 25.09.2000 dhe të pasojave që vijnë nga zgjidhja e martesës.

Bazuar në nenin 134 të K.Familjes, gjykata thirri palët në seancë për pajtim më datë 26.05.2022, ora 10:00, ku u paraqitën të dy bashkëshortët. Në këtë seancë, paditësja deklaroi se heq dorë nga gjykimi i padisë, pasi ekziston mundësia e pajtimit dhe vijimit të marrëdhëneve bashkëshortore. Paditësi deklaroi se nuk ka ndonjë kundërshtim dhe është i gatshëm të vijojnë marrëdhëniet bashkëshortore por paditësja duhet të punojë, të mos qëndrojë duke luajtur në internet gjithë ditën dhe ta respektojë atë.

Nisur nga sa më sipër, referuar nenit 299/ç të K.Pr.Civile, gjykata çmon se, duhet të vendoset pushimi i gjykimit, pasi kjo dispozitë përcakton: "**Gjykata vendos pushimin e gjykimit kur: ç) Pushimi i gjykimit parashikohet shprehimisht në ligj**". Heqja dorë nga gjykimi i padisë parashikohet në nenin 201/1 të K.Pr.Civile, i cili përcakton se: "**1. Paditësi në çdo fazë të gjykimit në shkallë të parë, mund të heqë dorë nga gjykimi i padisë. Heqja dorë ka efekt nëse i padituri e pranon atë. Megjithatë, pranimi i të paditurit nuk është i nevojshëm nëse ai, në kohën kur paditësi paraqet kërkesën për heqje dorë nga gjykimi, nuk ka dorëzuar ende deklaratën e mbrojtjes për themelin e çështjes**". Në rastin konkret paditësja deklaroi se heq dorë nga gjykimi i padisë dhe referuar parashikimeve të dispozitave

si më sipër, gjykata ka detyrimin ligjor të disponojë me vendim për pushimin e gjykimit të çështjes, pasi e drejta e disponimit të padisë i takon vetëm paditësit/es dhe njëkohësisht i padituri pranoi heqjen dorë.

Përsa i përket shpenzimeve gjyqësore, ato përbëhen nga tarifa mbi aktet dhe shpenzimet për njoftimet të parapaguara nga paditësja, të cilat duhet të lihen siç janë kryer.

Nisur nga fakti që midis palëve nuk ka detyrime, gjykata çmon se nuk ka vend që për këtë vendim të lëshohet urdhër ekzekutimi.

**PËR KËTO ARSYE:**

Gjykata, bazuar në nenet 201/1 e 299/ç të K.Pr.Civile dhe 134 të K.Familjes,

**VENDOSI:**

-Pushimin e gjykimit të çështjes civile me nr.21001-00754-41-2022 (995) regj. datë regjistrimi 12.05.2022, me paditëse Almira Hoxhaj (Merolli), i paditur Fatos Merolli, me objekt: Zgjidhjen e martesës ligjore të lidhur midis palëve më datë 25.09.2000 dhe të pasojave që vijnë nga zgjidhja e martesës.

-Shpenzimet gjyqësore të parapaguara nga paditësi lihen në ngarkim të tij.

-Kundër këtij vendimi, palët mund të bëjnë ankim të veçantë në Gjykatën e Apelit Korçë, brenda 5 (pesë) ditëve, duke filluar nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

-U shpall në Korçë, sot më datë 26.05.2022

**SEKRETARE**  
**Brilda HOXHALLARI**

**GJYQTAR**  
**Seladin PYSQYLI**